



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 06.03.2017



RAPORT PËR MUAJIN SHKURT 2017

Gjatë këtij muaji, sikur edhe muajin e kaluar me rëndësi të veçantë është bërë Inspektimi i subjekteve afariste hoteliere për zbatimin e Ligjit të Duhanit ku janë shqiptuar 4 Fletëparaqitje për Gjykatë për persona juridik dhe 11 gjoba për persona fizik si dhe Operatorëve të Transportit të udhëtarëve me qëllim të largimit të operatorëve ilegal ku është shqiptuar një Fletëparaqitje.

Punët janë realizuar duke kryer inspektimet në mënyrë ekipore dhe duke u angazhuar edhe Inspektorët e lëmive të tjera.

Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar përveq Ligjit të duhanit ka kryer inspektim të operatorëve ushqimor për kontrollin e produkteve të prodhuesit Bawella nga Turqia sipas Urdhërresës nga AUV, shqyrtimin e kërkesave të palës si dhe kërkesat e subjekteve për pëlqim sanitar.

Inspektori i Ndërtimit përveq punëve të ndërtimit ka qenë i angazhuar në tri komisione:

1. Komision për zgjerim të objekteve në pronë komunale (Zyra e Kryetarit)
2. Komision për vlerësim të rrezikut nga shembja e dheut (DHPE)
3. Komision për vlerësimin e dëmeve në Qender Tregtare në Drenas nga vërshimi i ujit për shkak të dëmtimit të gypave të ujit.

Inspektori i Komunikacionit ka bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçantë, kontrollë të Operatorëve ilegal.

Inspektorët e Tregut kanë inspektuar bizneset e ndryshme rreth pajisjes me dokumentacion të nevojshme, inspektim për afatin, çmimet e produkteve dhe deklaracion.

Inspektori Financiar ka evidentuar bizneset rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palës dhe verifikimin e bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave.

Lëmia Inspektuese	Procesverbalet	Aktivendime	Fletëparaqitjet	Gjohë mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa nga Palët	Shqyrtim i Kërkesave	Mbyllje të lokaleve
I.Sanitare	52	2	4	11	3	3	2	2	
I.Tregut	34	1					1	1	1
I.Financiare	51								
I.komunikacionit	15		1						
I.Ndërtimit	8	2		2					
I.Ambientit	13						4	2	